

**STATUTI I SHOQËRISË
"BS-ALB" SH.P.K**

Sot, më datë 05.04.2018, ortaku themelues **Walter Alberto TAMBURINI**, lindur në Castel di Lama (AP) me 05.06.1955, banues në Martinsicuro (TE) në via Bellini n. 4, i. 13, kodi fiskal Italian TMB LRT 55H05 C093B, me kartë identiteti N. AX 0234026, lëshuar nga Komuna e Martinsicuro më 12.05.2015, harton dhe nënshkruan statutin e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar, me përmbajtje si më poshtë vijon:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME
Emërtimi, Forma Juridike, Zyra Qendrore, Kohëzgjatja, Objekti

Hyrje
Baza Ligjore dhe Përkufizime

Në këtë statut:

"**Ligji**" do të thotë ligji Nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" duke përfshirë ndryshimet e herëpashershme që i bëhen;

"**Ligji i Regjistrimit**" do të thotë ligji Nr. 9723, datë 03.05.2007 "Për regjistrimin e biznesit" duke përfshirë ndryshimet e herëpashershme që i bëhen;

"**Statuti**" është dokumenti i vetëm ligjor i Shoqërisë, ku përcaktohet në mënyrë specifike rregullimi i veprimtarisë dhe organizimi i saj;

Neni 1
Emërtimi

Emri i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar është "**BS-ALB**" SH.P.K.

Neni 2
Forma Juridike

2.1. Shoqëria "**BS-ALB**" SH.P.K, është person juridik i së drejtës shqiptare, e organizuar në formën e *shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar* ("Shoqëria") dhe që ushtron aktivitetin e saj në përputhje me nenin 4 më poshtë.

2.2. Shoqëria fiton personalitetin juridik pasi të jetë regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit ("QKB"), në përputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara nga legjislacioni shqiptar dhe më pas është përgjegjëse ndaj të tretëve për detyrimet dhe dëmet e shkaktuara gjatë veprimtarisë së saj.

2.3. Shoqëria "**BS-ALB**" SHPK është themeluar nga ortaku i vetëm Walter Alberto TAMBURINI, i cili është përgjegjës për humbjet e saj deri në kufirin e vlerës së kontributit të tij në kapitalin themeltar.



1

Neni 3
Zyra Qendrore

3.1. Shoqëria e ka zyrën qendrore (selinë) në adresën: **«Rruga e Plazhit, Nd. 6, Lagjia Nr. 2, Divjakë, Fier»**.

3.2. Shoqëria, në përputhje me Ligjin dh legjislacionin tregtar në fuqi, mund të ndryshojë zyrën e saj qendrore, si edhe të hapë zyra përfaqësie, degë, si brenda ashtu edhe jashtë Republikës së Shqipërisë vetëm me vendim të asamblesë së përgjithshme të ortakëve (“Asambleja”)

Neni 4
Objekti

Objekti i veprimtarisë së Shoqërisë është:

- Kryerja e veprimtarive dhe ose pjesëmarrja në çdo veprimtari ose aktivitetet që ka lidhje me reklamimin, promovimin, sponsorizimin dhe ndërmjetësimin në sport dhe aktivitete sportive në Republikën e Shqipërisë dhe jashtë saj.
- Veprimtari tregtare në fushën e import-eksportit dhe tregtimin me pakicë e shumicë të të gjitha llojeve të mallrave.
- Hapjen e njësive tregtare, magazinave, etj në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe jashtë saj.
- Mirëmbajtje, blerje dhe shitje, ndërtime rrjetesh e programesh kompjuterike, software dhe hardware, brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.
- Ushtrimi i aktiviteteve që rrjedhin apo që ndihmojnë në realizimin e objektivave të mësipërm kryesorë.
- Marrja e financimeve nga institucione të ndryshme kredie, nga shoqëri, ente publike po private, në kuadër të realizimit të veprimtarisë së saj duke dhënë garancitë e nevojshme imobiliare, reale dhe personale, si edhe
- kryerja çdo lloj veprimtarie tjetër të nevojshme ose të dobishme në kuadër të realizimit të qëllimeve të Shoqërisë.

Neni 5
Kohëzgjatja

5.1. Kohëzgjatja e veprimtarisë së Shoqërisë është me afat të pacaktuar.

5.2. Veprimtaria e Shoqërisë fillon me regjistrimin në QKB.

A handwritten signature in black ink, consisting of a stylized, cursive script. The signature is located in the bottom right corner of the page.

KREU II KAPITALI

Neni 6

Kapitali themeltar

6.1. Kapitali fillestar i Shoqërisë është 1.500.000 lekë i cili është nënshkruar nga ortaku i vetëm Walter Alberto TAMBURINI.

6.2. Kontributi i ortakut/ëve mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme/të paluajtshme apo të drejta).

Neni 7

Zmadhimi i kapitalit

7.1. Kapitali i Shoqërisë mund të zmadhohet me vendim të Asamblesë të marrë me miratimin e ortakut/ëve që përfaqësojnë të paktën 80% (tetëdhjetë përqind) pjesë të kapitalit.

7.2. Zmadhimi i kapitalit nga njëri prej ortakëve nuk detyron ortakët e tjerë të zmadhojnë pjesët e tyre. Pjesët e kapitalit të ortakëve që nuk marrin pjesë në zmadhimin e kapitalit zvogëlohen në përpjestim me kapitalin e Shoqërisë vetëm nëse vendimi merret sipas Nenit 7.1 më sipër.

7.3. Zmadhimi i kapitalit të Shoqërisë mund të realizohet edhe nëpërmjet nënshkrimit dhe shlyerjes së pjesëve të reja të kapitalit nga ortakët që hyjnë në Shoqëri, të cilët do të pranohen të hyjnë në Shoqëri në cilësinë e ortakut me vendim të Asamblesë të marrë me miratimin e ortakët që përfaqësojnë të paktën 80% (tetëdhjetë përqind) pjesë të kapitalit.

Neni 8

Zvogëlimi i kapitalit

7.1. Zvogëlimi i kapitalit bëhet me vendim të Asamblesë. Zvogëlimi i prek ortakët në pjesët e kapitalit të zotëruara prej tyre, në mënyrë përpjestimore me zvogëlimin e kapitalit.

7.2. Projekti i zvogëlimit të kapitalit i paraqitet ekspertit kontabël të autorizuar të paktën 45 (dyzet e pesë) ditë nga mbledhja e Asamblesë e thirrur për këtë qëllim. Eksperti kontabël i paraqet Asamblesë raportin e tij në lidhje me arsyet dhe kushtet e zvogëlimit të kapitalit, pas shqyrtimit të projektit përkatës.

7.3. Vendimi i Asamblesë për zvogëlimi e kapitalit merret me miratimin e ortakut/ëve që përfaqësojnë të paktën 80% (tetëdhjetë përqind) pjesë të kapitalit..

Neni 9

Transferimi i kapitalit

9.1. Në çdo rast kalimi i kuotave do të bëhet me kontrate noteriale me shkrim.

9.2. Kuotat e Shoqërisë mund t'i transferohen të tretëve, por ortakët kanë të drejtën e parablerjes. Kjo e drejtë duhet të ushtrohet brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga marrja e njoftimit me shkrim nga ortaku, që do të transferojë kuotat me postë rekomande. Mosushtimi i kësaj të drejte brenda afatit të përcaktuar më lart i jep të drejtën e transferimit të kuotave zotëruarit



të tyre në favor të një personi të tretë. Ortakët kanë të drejtën e transferimit të kuotave të të tretët vetëm pasi të jetë marrë refuzimi me shkrim nga ortakët e tjerë ose të ketë kaluar afati 30 (tridhjetë) ditor, i përcaktuar më lart.

9.3. Personi që kalon kuotën dhe ai që e fiton atë përgjigjen në mënyrë solidare ndaj Shoqërisë për detyrimet që rrjedhin nga zotërimi i kuotës, nga çasti i kalimit të kuotave, deri në çastin e regjistrimit të kalimit në QKB, sipas nenit 43 të Ligjit të Regjistrimit. Regjistrimi i kalimit të kuotave ka efekt deklarativ.

9.4. Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve si dhe me rrugë trashëgimie.

KREU III **ORGANET VENDIM-MARRËSE DHE DREJTUESE**

Neni 10

Organet kryesore të Shoqërisë janë:

- Asambleja
- Administratori

Neni 11

Asambleja

Asambleja është organi i vetëm vendimmarrës i Shoqërisë. Asambleja merr vendime në lidhje me çështjet e mëposhtme (por pa u kufizuar vetëm në këto):

- a) përcaktimin e politikave të Shoqërisë;
- b) ndryshimet e Statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorit;
- ç) emërimin e shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat “c” dhe “ç” të kësaj pike;
- dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratori, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- g) përfaqësimin e Shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorit;
- gj) riorganizimin dhe prishjen e Shoqërisë;
- h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- i) çështje të tjera të parashikuara nga Ligji apo Statuti.

Neni 12

Mënyra e thirrjes së mbledhjes së Asamblesë

12.1. Asambleja thirret nga administratori apo ortakët e përcaktuar sipas nenit 84 të Ligjit.



12.2. Asambleja thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose postë elektronike në adresat e njoftuara nga ortakët. Njoftimi duhet të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7(shtatë) ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.

12.3. Kur Asambleja nuk është thirrur sipas pikës 12.2 të këtij neni, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.

Neni 13

Kuorumi

13.1. Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 80% (tetëdhjetë përqind) të kuotave.

13.2. Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar sipas nenit 87 të Ligjit, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse janë të pranishëm ortakët të cilët zotërojnë jo më pak se 80 % (tetëdhjetë përqind) të kuotave, kur ortakët janë të pranishëm personalisht apo votojnë me shkresë.

13.3. Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur me lart, asambleja mbledhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

Neni 14

Marrja e vendimeve

14.1. Asambleja e përgjithshme vendos me votat e ortakëve që zotërojnë jo më pak se 80% (tetëdhjetë përqind) të kapitalit për ndryshimin e Statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, miratimin e pasqyrave financiare, shpërndarjen e fitimeve/dividendëve, riorganizimin dhe prishjen e Shoqërisë, emërimin dhe shkarkimin e administratorit, likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar, përcaktimin e shpërblimeve për këta të fundit, përfaqësimin e Shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve, përcaktimin e politikave të Shoqërisë, si dhe miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të Asamblesë.

14.2. Çdo ndryshim në Statut duhet të depozitohet pranë QKB për të pasqyruar ndryshimet në skedën e Shoqërisë.

Neni 15

Përfaqësimi në Asamble

15.1. Ortaku mund të përfaqësohet në Asamble, nëpërmjet një autorizimi, nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.

15.2. Administratori i Shoqërisë nuk mund të veprojë si përfaqësues i ortakëve në Asamble.

15.3. Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të Asamblesë, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.



Neni 16

Administrimi

16.1. Asambleja e përgjithshme emëron një person fizik si administrator të Shoqërisë. Afati i emërimit të administratorit është **maksimumi 3 vjet**, me të drejtë ripërtëritjeje. Ai/ajo qëndron në detyrë deri në momentin e shkarkimit ose pranimit të dorëheqjes nga Asambleja. Administratori do të ushtrojë të gjitha kompetencat sipas parashikimeve të nenit 9 të Ligjit.

16.2. Administrator mund të emërohet edhe një person, që nuk është ortak i Shoqërisë.

16.3. Administratori mund të emërojë përfaqësues të posaçëm për akte të veçanta ose kategori aktesh.

16.4. Administrator i parë i Shoqërisë, duke filluar nga themelimi i saj, për një periudhë 3 (tre) vjeçare me të drejtë rizgjedhje, do të jetë:

Blendi TETA, shtetas shqiptar, lindur në Tiranë, më 14.09.1981, me nr. personal I10914050D.

Specimeni i nënshkrimit:



Neni 17

Kompetencat e administratorit

17.1. Administratori ka të drejtë e detyrohet të:

- a) kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të Shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga Asambleja;
- b) përfaqësojë Shoqërinë;
- c) kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të Shoqërisë;
- ç) përgatisë dhe nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqet këto dokumente përpara Asamblesë për miratim;
- d) kryejë regjistrimet dhe dërgojë të dhënat e detyrueshme të Shoqërisë, siç parashikohet në Ligjin e Regjistrimit.
- dh) raportojë përpara Asamblesë në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e Shoqërisë;

17.2. Administratori është i detyruar të thërrasë Asamblenë kur, sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e Shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim.



Neni 18

Viti Financiar

Viti financiar i Shoqërisë fillon me 1 janar dhe përfundon më 31 dhjetor. Përfundohet nga ky rregull, viti i parë financiar i cili fillon nga data e regjistrimit të Shoqërisë dhe mbyllet në 31 dhjetor.

Neni 19

Bilanci i Shoqërisë dhe dividendët

19.1. Brenda një periudhe 6 (gjashtë) mujore nga mbyllja e vitit financiar, Asambleja miraton bilancin e paraqitur nga administratori.

19.2. Mbledhja e Asamblesë vendos për shpërndarjen ose jo të fitimit, pasi të jenë zbritur humbjet e vitit të mëparshëm financiar, siç parashikohet nga Ligji.

19.3. Shoqëria mund t'u shpërndajë fitime ortakëve, vetëm nëse pas pagimit të fitimit:

a) aktivet e Shoqërisë mbulojnë tërësisht detyrimet e saj;

b) Shoqëria ka aktive likuide të mjaftueshme për të shlyer detyrimet që bëhen të kërkueshme brenda 12 muajve në vazhdim.

Neni 20

Ekspertët

20.1. Në rast se kërkohet nga legjislacioni në fuqi ose vendoset nga Asambleja, pasqyrat financiare të Shoqërisë dhe librat kontabël të saj mund t'i besohen një eksperti kontabël të autorizuar.

20.2. Eksperti kontabël i autorizuar mund të shkarkohet sipas procedurave të përcaktuara në Ligj.

Neni 21

Shpërndarja ose prishja e Shoqërisë mund të bëhet:

a) me vendim të Asamblesë;

b) me hapjen e procedurave të falimentimit;

c) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të Ligjit të Regjistrimit;

d) me vendim të gjykatës kompetente;

Neni 22

Likuidimi

22.1. Prishja e Shoqërisë sjell si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë pagueuse, me përjashtim të rastit kur është nisur një procedurë falimentimi.

22.2. Në rastin e likuidimit të Shoqërisë, Asambleja vendos për emërimin e një ose më shumë likuidatorëve, të cilët paraqesin raportet përfundimtare mbi gjendjen e aktivitetit dhe të



pasivit të Shoqërisë, mbi operacionet e likuidimit dhe kohën e nevojshme për të përfunduar likuidimin.

22.3. Me përfundimin e procedurës së likuidimit, Asambleja vendos mbi bilancin financiar përfundimtar, mbi punën e kryer nga likuiduesi dhe mbi përfundimin e procesit të likuidimit.

22.4. Pas pagimit të kreditorëve dhe mbledhjes së kredive, likuidatori do t'i shpërndajë të ardhurat përfundimtare të likuidimit ortakëve, në mënyrë përpjestimore me kuotat e zotëruara prej tyre në kapitalin themeltar të Shoqërisë.

Neni 23

Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve

23.1. Në lidhje me mosmarrëveshjet, të cilat mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij Statuti, kompetente do të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.


Neni 24

Dispozita përfundimtare

24.1. Gjithçka që nuk është parashikuar shprehimisht në këtë Statut do të rregullohet nga legjislacioni tregtar në fuqi dhe ligje të tjera të lidhura me të, të cilët janë në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

24.2. Ky statut u redaktua në 4 ekzemplare me përmbajtje dhe vlera të njëjtë ligjore, në gjuhën shqipe dhe u miratua në parim dhe nen për nen nga ortaku themelues i Shoqërisë, Z. Walter Alberto TAMBURINI.

ORTAKU THEMELUES Për Walter Alberto TAMBURINI



EMILIANO GJIKA

Përfaqësues me prokurën Nr. 21036 Rep. dhe 12823 Kol.
regjistruar në Foggia më datë 13.12.2017 me Nr. 6591/1T
përpara noterit Fabrizio Pascucci